

VENDIM
Nr. 582, datë 22.7.2026

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 10, DATË 15.1.2026, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME
KONTRATË TË PËRKOHSHE, PËR VITIN 2026, NË NJËSITË E QEVERISJES
QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 10, datë 15.1.2026, të Këshillit të Ministrave, shtohet lidhja nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pagesa për punonjësit e përfshirë në emërtesën “Specialist arkivi (DPA)”, sipas lidhjes nr. 2, kryhet nga institucionet përkatëse, pas miratimit të listëprezencës dhe shënimeve përkatëse të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Këta punonjës ushtrojnë veprimtarinë e tyre pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

3. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në lidhjen nr. 2 të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, së bashku me kategorinë e pagës.

4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.8.2026.

Ky vendim hy në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi

Lidhja nr. 2					
Gr.	Emri i institucionit	Numri i punonjësve 2026	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periodha kohore
4	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit	10	Specialist Arkivi (DPA)	8 orë/ditë	5 muaj
5	Aparati i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	10	Specialist Arkivi (DPA)	8 orë/ditë	5 muaj
6	Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë	20	Specialist Arkivi (DPA)	8 orë/ditë	5 muaj
10	Aparati i Ministrisë së Financave	5	Specialist Arkivi (DPA)	8 orë/ditë	5 muaj
11	Aparati i Ministrisë së Arsimit	10	Specialist Arkivi (DPA)	8 orë/ditë	5 muaj
13	Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	5	Specialist Arkivi (DPA)	8 orë/ditë	5 muaj
14	Aparati i Ministrisë së Drejtësisë	10	Specialist Arkivi (DPA)	8 orë/ditë	5 muaj
15	Aparati i Ministrisë për Evropën dhe Punëve të Jashtme	5	Specialist Arkivi (DPA)	8 orë/ditë	5 muaj
16	Aparati i Ministrisë së Punëve të Brendshme	5	Specialist Arkivi (DPA)	8 orë/ditë	5 muaj
17	Aparati i Ministrisë së Mbrojtjes	20	Specialist Arkivi (DPA)	8 orë/ditë	5 muaj
TOTAL	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	100			